



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

DETARI

Niveli II në KSHK¹, referuar nivelit II të KEK²

J-II-20

Tiranë, 2020

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	Detari			Kodi
	Kohëzgjatja	Niveli	II në KSHK, referuar nivelit II të KEK	
Kohëzgjatja	1800-2100 orë	Niveli	II në KSHK, referuar nivelit II të KEK	J-II-20
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Detari” niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, është të pajisë individët me njohuritë dhe shprehitë bazë për sigurinë personale dhe përgjegjësitë kolektive, dhënien e ndihmës së parë, emergjencat në një mjet lundrimi, artin detar, lundrimin, puna dhe shmangia e tej-lodhjes në anije. Gjithashtu, individi pajiset me njohuritë bazë të funksionimit të pajisjeve kryesore elektromekanike në një mjet lundrimi si dhe veprimet e thjeshta në raport me operimin e tyre. Ai/Ajo pajiset me njohuritë dhe shprehitë bazë të fushës së detarisë duke i dhënë mundësinë për t’u imbarkuar në një mjet lundrimi tregtar, të shërbimit portual, të forcave të zbatimit të ligjit apo edhe të shërbejë në repartet e mirëmbajtjes së veglave të peshkimit.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në ofruesit e kualifikimeve profesionale në “Detari”, niveli II në KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që: - kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar; - janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional në “Detari”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, e pajisë nxënësin me Çertifikatat Profesionale të Trajnimit Bazë për të gjithë personelin që punon në anijet e peshkimit sipas Konventës Ndërkombëtare të STCW '78 ¹ , i amenduar dhe/ose STCW-’95 ² . – Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në një: a. mjet lundrimi për qëllime tregtare; b. mjet lundrimi të shërbimeve portuale; c. mjet lundrimi të Rojës Bregdetare ose të agjencive të tjera ligj-zbatuese në det; d. mjet lundrimi për qëllime peshkimi në det dhe në ujërat e brendshme; e. mjet lundrimi kërkimor shkencor, praktike mësimore f. mjet lundrimi për qëllime argëtimi - çlodhje në det g. fermë të rritjes artificiale në ujërat e ëmbla, njelmëta ose bregdet; h. stabiliment të përpunimit të peshkut; i. pikë shërbimi mirëmbajtje dhe riparimi për veglat e peshkimit;			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparëshme	J-II-15			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Individi duhet të dijë:

Art detar

Hyrje në Artin Detar

- Të identifikojë tipet e anijeve;
- Të dallojë elementet fillestare konstruktive të anijes;
- Të rendisë sistemet bazë të anijes;
- Të përshkruajë funksionin dhe procesin e mirëmbajtjes së mekanizmave dhe pajisjeve të kuvertës;
- Të përshkruajë mirëmbajtjen e cimave dhe kavove;
- Të përshkruajë funksionin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të takilazhit;
- Të tregojë rregullat e mirëmbajtjes së anijes që kanë të bëjnë me jetëgjatësinë e saj;

Rregulla të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë

- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik në sektorin e kuvertës;
- Të përshkruajë detyrat gjatë shërbimit në anije dhe emergjencat e mundshme në të;
- Të përshkruajë rregullat e punës dhe pushimit për shmangien e tej-lodhjes;
- Të përshkruajë rregullat e hyrjes dhe punës në një hapësirë të mbyllur;

Higjiena në anije dhe Mbrojtja e Mjedisit Detar

- Të listojë rregullat e higjienës në anije;
- Të përshkruajë rregullat e trajtimit të mbetjeve në anije;
- Të përshkruajë masat për parandalimin e ndotjeve të mjedisit detar;
- Të përshkruajë veprimet reaguese në raste ndotjesh të mjedisit detar;

Lundrim

Njohuritë bazë për imbarkimin e nxënësit për lundrim

- Të përshkruajë rolin e mjeteve individuale dhe kolektive të shpëtimit të jetës së njeriut në det;
- Të përshkruajë parimet dhe veprimet për mbijetesë në mjetet kolektive të shpëtimit të jetës së njeriut në det;
- Të përshkruajë parimet e përgjegjësisë vetjake dhe shoqërore në ambientet e mjetit lundrues;
- Të përshkruajë rolin e pajisjeve të mbrojtjes nga uji e zjarri në anije si dhe mirëmbajtjen e tyre;
- Të përshkruajë parimet dhe veprimet për dhënien e ndihmës së parë në det;
- Të përshkruajë parimet kryesore të sigurisë detare (maritime security);

Elementët fillestar të lundrimit

- Të përshkruajë parimin e arkimit dhe zbatueshmëria e tij në lundrim;

- Të përshkruajë faktorë që ndikojnë në lëvizjen dhe drejtimin e anijes;
- Të tregojë komandat që përdoren gjatë operacioneve të manovrave të anijes;
- Të përshkruajë rregullat e omërgjimit të sigurt të mjetit lundrues në port;
- Të përshkruajë veprimet e anijes për lidhjen allaj (trup i dytë);
- Të përshkruajë veprimet e anijes për zhvendosje përgjatë bankinës;
- Të dallojë sinjalet zanore dhe dritëdhënëse për parandalimin e përplasjeve në det;
- Të përshkruajë pasojat e mundshme që i vijnë anijes gjatë qëndrimit në spirancë;
- Të tregojë mënyrat e hedhjes dhe ngritjes së spirancës;
- Të skicojë lëvizjet e anijes për lidhjen dhe largimin nga bova;
- Të tregojë rregullat që zbatohen gjatë procesit të rimorkimit;
- Të listojë llojet e rimorkimit;

Njohuri bazë të elektromekanikës në anije

- Rregulla të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në sektorin e makinerisë;
- Të përshkruajë klasifikimin e motorëve me djegie të brendshme;
- Të përshkruajë ndërtimin e motorit;
- Të përshkruajë sistemet dhe funksionin e tyre tek motorët detarë;
- Të përshkruajë sistemin tradicional të lëvizjes dhe drejtimit të anijes dhe ato bashkëkohorë;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionin e agregateve të instaluar në anije (makineri dhe kuvertë);
- Të shpjegojë sistemet e ndryshme të tubacioneve në anije;
- Të përshkruajë burimet e energjisë, panelet e kontrollit, linjat e shpërndarjes dhe pajisjet elektrike;
- Të përshkruajë sistemet kryesore të depove të karburantit dhe monitormimit të tyre;
- Të shpjegojë llojet, vetitë dhe trajtimin e hidrokarbureve në anije;
- Të përshkruajë mënyrën e trajtimit të ujërave të zeza nga anijet;
- Të përshkruajë metodat e mbledhjes, ruajtjes, trajtimit dhe dorëzimit të mbetjeve hidrokarbure;
- Të listojë detyrat e detarit të thjeshtë në sektorin e makinerisë;

Hidrometeorologji

- Të përshkruajë vrojtimin në anije për elementët hidro-meteorologjikë;
- Të përshkruajë atmosferën dhe elementët e saj;
- Të përshkruajë llojet rrezatimit diellor;
- Të shpjegojë parimet e ngrohjes, ndriçimit dhe rrezatimit të tokës;
- Të përshkruajë elementët e nxehtësisë dhe ftohjes së ajrit;
- Të shpjegojë lëvizjet e ajrit dhe shtresat termike;
- Të dallojë shkallët e matjes së temperaturës në njësi të ndryshme;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e instrumenteve matës të temperaturës;
- Të përshkruajë ndryshimet e temperaturës, kripsmërisë dhe dendësisë në dete dhe oqeanë;
- Të përshkruajë formimin e avujve në atmosferë dhe shtypja e tyre;
- Të përshkruajë ndryshimet midis lagështirës relative dhe absolute;
- Të përshkruajë aparatet matëse të lagështirës dhe parimin e punës;
- Të shpjegojë shkaqet e kondensimit;
- Të përshkruajë mjegullat dhe llojet e tyre;
- Të tregojë retë dhe klasifikimin e tyre;
- Të përshkruajë llojet e reshjeve;

- Të përshkruajë faktorët që shkaktojnë stuhi dhe dukuri të tjera meteorologjike në det;
- Të tregojë parimin e punës, funksionimin dhe leximin e shimatësit;
- Të dallojë njësitë matëse dhe ndryshimet atmosferike në lidhje me lartësinë dhe temperaturën;
- Të shpjegojë shpërbërjen gjeografike të shtypjes atmosferike, veçanërisht në detet tona;
- Të tregojë parimin e punës dhe leximin e barometrave dhe barografit;
- Të argumentojë shkaqet e formimit të erës, strukturën dhe elementët e saj;
- Të përshkruajë regjimet e erërave në det dhe ndikimi saj në valët e detit;
- Të dallojë njësitë matëse të ballëve të erës dhe detit dhe elementët e tyre;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe leximin e erëmatësit;
- Të përshkruajë rrymat detare, shkaqet dhe elementët e tyre;
- Të përshkruajë relievin e detit, veçanërisht të detit Adriatik dhe Jon;
- Të shpjegojë formimet barike dhe lëvizjet e masave ajrore;
- Të dallojë ciklonet dhe anticiklonet, shenjat paralajmëruese dhe veçoritë e motit gjatë këtyre dukurive;
- Të dallojë ngjarjet atmosferike, shenjat konvencionale dhe një hartë të thjeshtë moti;

Teknologji peshku

- Të tregojë kushtet teknike për rritjen e përbërjes mishtore dhe të freskisë së peshkut;
- Të tregojë rregullat e ndërhyrjes për ruajtjen e freskisë së peshkut gjatë transportimit;
- Të përshkruajë format e ruajtjes së freskisë së peshkut në të thatë dhe në të njomë;
- Të tregojë teknologjinë e kriposjes në të thatë e të njomë pas zënies në anije dhe në fermë rritje;
- Të përshkruajë llojet e ambalazheve dhe lëndët konservuese që përdoren në përpunimin e peshkut;

Ihtiologji

- Të shpjegojë rëndësinë e peshkut për ushqimin e njeriut;
- Të tregojë ndërtimin anatomik dhe fiziologjik të peshqve të ndryshëm;
- Të përshkruajë biologjinë e riprodhimit të peshkut;
- Të përshkruajë sistematikën e klasës së peshqve;
- Të përshkruajë strukturat e popullimit dhe faktorët që ndikojnë në strukturën moshore të popullimit;
- Të shpjegojë fenomenin e migracionit dhe si ndikon ai në shtimin, kullotjen e dimërimin e peshkut;
- Të përshkruajë parimet e ruajtjes së rezervave të peshkut;
- Të përshkruajë llojet e specieve të familjeve të ndryshme të peshqve të ujërave të ëmbla dhe të kripura;

Teknikë peshkimi

- Të tregojë etapat e zhvillimit të teknikës së peshkimit, shtrirjen e aktivitetit në ditët e sotme;
- Të përshkruajë cilësitë, sistemet dhe ndërtimin e lëndëve të fijezuara sintetike dhe bimore;
- Të përshkruajë llojet e litarëve dhe përdorimin e tyre në veglat e peshkimit;
- Të përshkruajë llojet dhe efektet vepruese të pluskuesve që përdoren në veglat e peshkimit;
- Të përshkruajë llojet dhe efektet vepruese të peshave që përdoren në veglat e peshkimit;
- Të përshkruajë zonën hapësinore të syzës dhe sipërfaqen e efektshme të saj;
- Të përshkruajë shkaqet dhe pasojat e dëmtimit dhe konsumit të një rrjete;
- Të përshkruajë shërbimet që i bëhen veglave të peshkimit;
- Të përshkruajë teknikën e peshkimit me varg grepash;

- Të përshkruajë teknikën e peshkimit me rrethim pasiv në bregdet;
- Të përshkruajë teknikën e peshkimit me kosha rrethues;
- Të përshkruajë teknikën e peshkimit me kutia notuese;

Rritje artificiale

- Të argumentojë rëndësinë e zhvillimit të peshikulturës në ndihmë të agroturizmit;
- Të përshkruajë tipet dhe sistemet e fermave për rritjen dhe kultivimin e peshqve;
- Të përshkruajë procesin e rritjes dhe kultivimit të molusqeve në zonat bregdetare;
- Të përshkruajë procesin e rritjes dhe kultivimit të peshqve bregdetarë;
- Të përshkruajë procesin e rritjes dhe kultivimit të kocës dhe levrekut në fermat dhe lagunat bregdetare;
- Të përshkruajë procesin e rritjes së peshqve bregdetarë me kosha stacionarë;
- Të përshkruajë përdorimin e ushqimeve natyrale dhe artificiale për rritjen e peshqve bregdetarë;
- Të përshkruajë format e rritjes së peshkut në ferma peshkimi, në liqene dhe rezervuarë ;
- Të përshkruajë procesin e rritjes dhe kultivimit të ngjalës në fermat pranë rezervuarëve vaditës;
- Të përshkruajë procesin e rritjes dhe kultivimit të qefujve në ujëra të njelmëta;
- Të përshkruajë faktorët fiziko-kimik të mjedisit ujor që ndikojnë në mbarëvajtjen e një ferme peshku;
- Të tregojë lëndët organike dhe ndikimin e tyre në mjedisin ujor;
- Të listojë klasifikimet e ujërave sipas përmbajtjes kimike.
- Të tregojë masat për një transport të sigurt të rasateve nga zonat bregdetare deri në fermat e peshkimit;
- Të listojë sëmundjet e peshqve dhe masat për parandalimin e përhapjes së tyre;

SHPREHI PROFESIONALE

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

Art detar

- Të notojë në dy stile të ndryshme;
- Të familjarizohet me rregullat e hyrjes, qëndrimit, punës dhe daljes së sigurt nga mjeti i lundrimit;
- Të vozisë me mjete të thjeshta lundrimi;
- Të realizojë nyjet (lidhjet) detare;
- Të qepë cima dhe kavo;
- Të kryejë punime të thjeshta mirëmbajtëse të sipërfaqeve të kurvertës dhe agregateve të saj;
- Të punojë në grup për operimin e mekanizmave të kuvertës;
- Të kryejë veprimet për mbledhjen, ruajtjen dhe dorëzimin e mbetjeve të ngurta në anije;
- Të kryejë veprimet dhe shërbimet në bord duke mos-ndotur mjedisin detar;
- Të reagojë sipas udhëzimeve në rastet e ndotjes së mjedisit detar;
- Të marrë masat për ruajtjen e higjienës në anije;
- Të zbatojë raportin e kohë shërbim-pushimit për shmangien e tej-lodhjes;
- Të asistojë në kryerjen e punimeve jashtë bordit dhe në një hapësirë të mbyllur;
- Të kryejë kontrolle pamore për mbajtjen në gatishmëri përdorimi të mjeteve të shpëtimit të jetës,

mbrojtjes nga zjarri;

- Të realizojë matjen e tankeve të ndryshme nën mbikëqyrjen e detarit të kualifikuar;

Lundrim

- Të zbatojë kriteret e sigurisë personale dhe përgjegjësisë kolektive në anije;
- Të kryejë veprimet për parandalimin dhe luftën kundra zjarrit në mjetin lundrues;
- Të kryejë veprimet sipas teknikave të mbijetesës në det;
- Të japë ndihmën e parë mjekësore;
- Të zbatojë detyrat individuale dhe në grup lidhur me emergjencat e identifikuara;
- Të vëzhgojë gjatë shërbimit elementë të sigurisë gjatë qëndrimit të anijes në bankinë, bovë apo spirancë dhe të raportojë;
- Të vëzhgojë gjatë shërbimit sinjalistikën lundrimore natën/ditën dhe të raportojë;
- Të përcaktojë distancat nga anija në bankinë, shpejtësinë dhe kahun e lëvizjes së anijes;
- Të përdorë cimat për akostim dhe ç ‘akostim nga bankina;
- Të punojë në grup për akostimin dhe zhvendosjen e mjetit lundrues në dhe përgjatë bankinës;
- Të punojë në grup për lidhjen e mjetit lundrues në bankinë apo trup i dytë (allaj);
- Të asistojë nostromin për hedhjen/marrjen e spirancës;
- Të manovrojë me timonin sipas një komande të dhënë;
- Të respektojë rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Të përdorë në mënyrë të pavarur literaturat profesionale;
- Të përdorë terminologjinë detare në emërtim, interpretim dhe raportim;

Shprehitë bazë të elektromekanikës në anije

- Të familjarizohet me rregullat e hyrjes, qëndrimit, punës dhe daljes së sigurt nga lokali i makinerisë;
- Të kryejë punime pastrimi të agregateve dhe sipërfaqeve në lokalin e makinerisë;
- Të realizojë ndërrime të llambave të ndriçimit në lokalin e makinerisë;
- Të realizojë pastrim të filtrave të naftës dhe të vajit në lokalin e makinerisë;
- Të kryejë ndezjen dhe fikjen e pompave të ndryshme në lokalin e makinerisë sipas udhëzimit dhe nën mbikëqyrjen e mekanikut të kualifikuar;
- Të realizojë takimin dhe s ‘takimin e energjisë për agregate të ndryshme në bord sipas udhëzimit dhe nën mbikëqyrjen e mekanikut të kualifikuar;
- Të realizojë vaisjen dhe grasatimin e agregateve në makineri, në lokalin e timonit si dhe kuvertë;
- Të kryejë shërbime ndihmëse nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e mekanikut të kualifikuar;
- Të realizojë matjen e tankeve të ndryshme në makineri nën mbikëqyrjen e mekanikut të kualifikuar;
- Të marrë pjesë sipas udhëzimeve në marrjen e masave për furnizimin e me karburant;
- Të marrë pjesë sipas udhëzimit në dorëzimin e mbetjeve hidrokarbure në porte;

Hidrometeorologji

- Të marrë informacion për motin nga instrumentet matës dhe informues në anije, si dhe nga tregues të tjerë të motit;
- Të mirëmbajë instrumentet matës të informacionit meteorologjik në anije;

Teknologji peshku

- Të sistemojë produktin e kapur gjatë peshkimit;

- Të ruajë freskinë e produktit nga momenti i zënies deri në daljen e tij në treg;

Ihtiologjia

- Të matrikulojë ekzemplare të veçantë peshqish për nevoja studimi;
- Të përcaktojë moshën e peshkut nëpërmjet luspave dhe organeve gjenitale;
- Të bëjë markimin e peshqve në sezone të ndryshme gjatë vitit;
- Të përcaktojë ritmin e rritjes së peshqve sipas matjeve biometrike;
- Të marrë mostra e ujit në thellësi të ndryshme;
- Të përcaktojë kriptomërinë me anë të matësit të kriptomërisë;
- Të përcaktojë densitetin e ujit;
- Të përcaktojë temperaturën në periudha të veçanta gjatë vitit;
- Të përcaktojë pehashin (pH);
- Të përcaktojë moshën e peshkut

Teknikë peshkimi

- Të qepë dy tegela me njëri tjetrin kur ka ndryshime në prerje, madhësi syze dhe drejtim;
- Të realizojë mënyrat dhe drejtimet e qepjes së rrjetës në litar;
- Të marrë pjesë në gjuetinë me vegla syzëpërfshirës, stacionarë, rrethues etj.;
- Të zbatojë kriteret e jetëgjatësisë dhe mirëmbajtjes së materialeve të veglave të peshkimit;
- Të kryejë punime mirëmbajtjeje dhe riparime të thjeshta të veglave të peshkimit;
- Të përgatisë për gjueti veglat e peshkimit sipas specifikës së shërbimit;
- Të sistemojë veglën e peshkimit pas gjuetisë në kushtet praktike;
- Të marrë pjesë në ndërtimin e koshave sipas kushteve të trajtimit të tyre;
- Të marrë pjesë në zënien e rasateve në laguna apo gryka lumenjsh;

Rritje artificiale

- Të përcaktojë nevojat e furnizimit me ujë të një ekonomie peshkimi;
- Të marrë mostra uji dhe dheu për të bërë analizat e nevojshme laboratorike;
- Të marrë pjesë në krijimin e kushteve hidrobiologjike të kultivimit të peshkut
- Të marrë pjesë në krijimin e kushteve të nevojshme për trajtimin e riprodhuesve;
- Të përgatisë pellgjet e shtimit sipas parametrave të nevojshëm për furnizimin me ujë;
- Të përdorë ushqimet koncentrate si dhe kombinacionet në recetat ushqimore.
- Të marrë pjesë aktive për kultivimin e familjes së qefujve, koces, levrekut, ngjalës etj.

KOMPETENCA TE PERGJITHSHME

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në

kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;

- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

¹ Konventa e Standardeve të Trajnimit, Çertifikimit dhe Shërbimit për Detarët e vitit 1978, e amenduar.

² Konventa e Standardeve të Trajnimit, Çertifikimit dhe Shërbimit për Peshkatarët e vitit 1995.